



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
  
**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština – Municipality of Prishtina**



---

**EKSTRAKT I PROCESVERBALIT**

**nga dëgjimet publike, për planifikimin e buxhetit për vitin 2026, mbajtur më 4.8.2025, i cili filloi në orën 14:00.**

**Të pranishëm ishin:** Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Valbona Vitija, drejtoreshë në Drejtorinë e Administratës, Sibel Halimi, drejtoreshë në Drejtorinë e Kulturës, Adelina Sahiti, drejtoreshë në Drejtorinë e Mirëqenies Sociale dhe Bekim Gashi, drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Publike.

**Në diskutim mori pjesë qytetari:** Isa Rexha, kryetar i këshillit lokal Barilevë-Drenocë.

**Valbona Makolli:** tha se dëgjimet janë dëgjime të rregullta buxhetore 2026, janë të ndara në disa fusha për arsye secila me pas kohën e vet, me i paraqitë kërkesat buxhetore të vitit 2026. Sot janë shoqëritë civile dhe OJQ-të, të cilat i përkasin fushës së sportit, shëndetësisë, mirëqenies sociale, me i paraqitë kërkesat të dy pjesëmarrësve që janë këtu.

**Isa Rexha- kryetar i këshillit lokal Barilevë dhe Drenocë:-** kërkesat unë ia kam dërgu kryetarit dhe çdo drejtori të drejtorisë përkatëse me email. Për sport e kemi një stadion i cili nuk është caktuar pika, ka kaluar në asamblenë komunale, ka vazhduar në diskutim është votuar, drejtori i pronës se di përse nuk i ka vendos pikat. Në 84, pronari i autobusit “Edona” i ka jep 5 mij marka ajo pjesë me u bë stadion, ende figuron kullos. Tash si me e vendos në buxhet? Drejtoreshën e Administratës e përshëndesë, më ka premtuar për zyrë qe 1 vit.


**Valbona Vitija:** përshëndetje për të gjithë, ju faleminderit për punën që jeni duke e bërë në pjesën ku jeni zgjedhë kryetar, po e përfaqësoni me të drejtat më të mira kërkesat e qytetarëve. Unë ju kam premtuar zyrën, po siç e dini që kemi qenë ende duke përzgjedh të gjithë kryetarët, së shpejti do të bëjmë një takim dhe do e bëjmë njëjtë zgjedhjen njëjtë për të gjithë. Bashkësia Lokale në vendin tuaj është mbyll, kemi me e prurë edhe zyrtarin me e funksionalizuar atë bashkësi ku edhe juve do ju takoj një zyrë patjetër, faleminderit shumë.

**Valbona Makolli:** faleminderit për pjesëmarrjen, meqenëse s’ka pjesëmarrës tjerë ju falenderoj juve dhe kolegët e përmbyllim për sot. Faleminderit shumë.



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Dëgjimet publike për planifikimin e buxhetit për vitin 2026,  
4 Gusht, 2025  
Kryeqyteti - Prishtinë / Kuvendi Komunal

| Nr. | Emri/Name | Mbiemri/Surname | Titulli/Title | e-mail     | Nënshkrimi/Signature |
|-----|-----------|-----------------|---------------|------------|----------------------|
| 1   | Isaferis  | Meris           | Kryetari i L. |            |                      |
| 2   | Durim     | Bestirita       |               | PCBARKU@17 |                      |
| 3   |           |                 |               |            |                      |
| 4   |           |                 |               |            |                      |
| 5   |           |                 |               |            |                      |
| 6   |           |                 |               |            |                      |
| 7   |           |                 |               |            |                      |
| 8   |           |                 |               |            |                      |
| 9   |           |                 |               |            |                      |
| 10  |           |                 |               |            |                      |

P.S \*Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!  
\*Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohen! \*